



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:038515

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03076898

E.nr.1096/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditores R.A nga Feriza,j të cilin e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 31.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.1096/21, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1096/21, të datës 15.09.2021, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.554/20, të datës 22.12.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 02.02.2022, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,182.63 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1096/21, më datë 31.05.2022

GJYQTARI
Faton Ajvazi